



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE BALDUSHK

Nr.964 Prot.

Tiranë, me 23.11.2017

Proces Verbal

I mbajtur sot me date 23.11.2017 mbi degjese publike per buxhetin e vitit 2018 . Ne takim ishin të pranishëm **Administratori i Njesisë Administrative Baldushk Z. Ilir BERMETA** dhe **Z. Erind BEJKO**, Drejtor ne Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi , Kordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile, Nderlidhesit me komunitetin si dhe banore te kesaj Njesie.

Administrtrori i Njesise Administrative Baldushk Z. Ilir BERMETA , pasi falenderon pjesmarësit për pjesmarrjen dhe interesin për zhvillimin e këtij takimi të rëndësishëm, ben nje permbledhje te investimeve qe ka prioritet Njësia Administrative Baldushk .

Prioritet mbeten per vitin 2018 :

- Riparimi dhe shtimi i ambiteve te shkolles “Fushas”
- Riparimi shkolles cikli ulet fshati Mustafakoc
- Shtrimi Rruges ne fshatin Mustafakoc e quajtur Unaza
- Shtrimi i Rruges “Feti Vogli”
- Shtrimi i Rruges Kocaj-Veski-Parret
- Shtrim i Rruges se Vrapit
- Shtrim i Rruges Kocaj-Kakunje
- Investim per Ndertimin e Ures Kocaj
- Nderhyrje per kualifikimin Urban te Qndres se Njesise Administrative
- Investim per zyrat e Njesise Administrative Baldushk .

Z. Erind Bejko Drejtor ne Drejtorinë e Objekteve në bashkëpronësi , Kordinimi I Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile

Falenderon pjesmaresit dhe shprehet , se kjo eshte nje degjese , ku ne do degjojme kerkest tuaja ne lidhej me investimet per kete vit . **Z. Erind BEJKO** u shpreh Baldushku eshe nje nga zonat qe nuk ka problematike sic do Njesi tjeter me rrugen kryesore dhe eshte nje nga zonat me piktoreske dhe qe ka nevoje per me shume investime ne infrastruktura .

Investime te sigurta per vitin 2018 jane:

- Vendosja e Konteniereve.
- Rehabilitimi dhe kualifikim Urban i qendres se Njesise Administrative.
- Riparimi dhe shtes e Shkolles “Fushas”.
- Shtrimi i Rruges “Feti Vogli”

Drejtori i Bashkisë Tirane u shpreh se per vitin 2018 parashikohen këto investime :

- Ngritja e nje Tregu ose pike Grumbullimi per prodhimet Bujqesore dhe Blektorale.
- Investime ne infrastruktura nga “Fondi I Zhvillimit Shqiptar.
- Projekt qe perfshin dhe fshatrat me te thella (per promovimin e turizmit)

Diskutimi vazhdoi ne formën e një bashkëbisedimi ,ku u shprehën opinionet dhe kerkesat e pjesmarësve per vitin 2018 .

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Baldushk

- Kerkon ndertimin e nje rezervuari ne kete fshat qe lidh dy fshatra (Baldushk-Balshaban) .
- Infrastruktura ku kerkohet nderhyrje ne 5 segmente rrugore dhe nje segment ku eshte 400 m ku rruga eshte e pakalueshme.
- Per ndertimet mos te jete e njejta procedure si per fshatin dhe qytetin nje problem per te gjithë banoret.

Perfaqesuesi Bashkise u shpreh , se do futet ne projekt bashke me projektin ekzistues te qendres se Njesise.

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Mumajes

- Jemi nje fshat me 83 familje na mungon uji i pijeshem per 180 m tub nuk lidhemi me rrjetin e ujesjellesit.
- Sistemi i vaditjes ku mungojne 400 m tub per lidhjen me elektropompen e cila eshte ne funksion.
- Riparimi I shkolles 9-vjecare fushas pasi eshte rrezik per femijet.
- Vendosja e konteniereve te mbeturinave per rrjedhoje se po ndotet lumi “Zhullime”

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Vrap

- Shtrimi i Rrugës së Vrapit pasi është bërë e pakalueshme.

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Veski

- Rruga Kocaj-Veski- është bërë e pakalueshme kërkojmë ndihmën tuaj për nderhyrje pasi projekti është i gatshëm.

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Mustafa-Kocaj

- Riparimi i shkolles cikli ulet Mustafakoc .
- Te riparohet ujeleshuesi i Rezervuarit te Zelajve.
- Te behet nderhyrje ne Rruget e pashtruara

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Shenkollë

- Eshtë i vetmi fshat që ska rrugë fare kërkojmë nderhyrjen tuaj.

Qytetari (I) banues ne Fshatin Parret

- Ankese për Rrugën Parret dhe për transportin e Femijeve për në shkollë.

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit Isuf-Mucaj

- Riparimet e kanaleve kulluese dhe vaditese.
- Uji I pijshem mungon edhe pse rrjeti I ujesjellesit eshte funksional.
- Rritja e pages se nderlidhesve.

Qytetari: II banues ne Fshatin Balshaban

- Diskutimi u zhvillua për për pushtetin vendor dhe për arritjet e Kryetarit të Bashkisë.
- Une mendoj që planet që keni për Njesinë tonë të investoni në kohë dhe mos na diskriminoni.
- Kam një sërë ankesash për Drejtorin e Transportit Rrugor dhe për Linjen e autobusave , e cila nuk jep bileta të licensuara. Kjo pasi çmimi i biletave është shumë i lartë dhe nuk i mërr leket në baze të kilometrave.

- Ne si banore, paguajme sipas ligjit dhe ju duhet te veproni sipas ligjit.
- Rezarvuaret duhet te mirmbahen dhe te shtohen

Nderlidhesi me Komunitetin i Fshatit “Kakunje”

- Te dyja urat e fshatit kane nevojte per riparim, pas rreshjeve te fundit jane shkaterruar dhe femijet rrezikojne mos ndjekjen e shkolles.
- Rruga eshte e pashtuar.

Qytetari IV

- Eshte e domosdoshme ujitja per prodhimin.
- Shtimi i prodhimeve bujqesore duhet realizuar ndermjet ngritjes te nje tregu ne qytet prane Rruga se Elbasanit.

Qytetari V

- Taksat e faturave te ujit, jane shume te larta.
- Qendra Shendetesore nuk e ka disponibel mjekun , 24 ore.
- Ngritja e aktiviteteve specifike per te rinjte

Qytetari VI

- Eshte e rendesishme , venia dore ne bujqesi.
- Mundesimi i ujit vadites.
- E domosdoshme eshte dhe krijimi i nje pike grumbullimi per perimet.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin

Ilir BËRMETA

ADMINISTRATORI